



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

FTESË PËR APLIKIM PËR ANËTARË TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR PROJEKTET NGA FUSHA E TEATRIT

Bazuar në rregulloren e MF-NR-04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të – Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit si dhe e bazuar në thirrjet publike: nr. Protokolit 09-024/01-0077274/22 datës 07.09.2022 të aplikojnë për të marrë pjesë në komisionin e vlerësimit nga fusha e teatrit.

- I. Për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekt propozimeve të OJQ-ve, për realizimin e shfaqjeve për skenën e fëmijëve në Teatrin "Avdush Hasani".

Të gjithë qytetaret e Republikës së Kosovës të cilet nuk janë nën hetime apo me procedura penale dhe që kanë përvojën dhe njohuri në fushën e teatrit, u mundësohet të aplikojnë për pjesëmarrje në Komisionin Vlerësues në cilësinë:

- Një përfaqësues nga OJQ-të
- Një ekspert të fushës

Përfaqësuesi/ja e lartëcekur që përzgjidhet do të jetë anëtar/e e komisionit vlerësues me të drejtë vote për vlerësimin e projekt-propozimeve komfor procedurave të rregullta administrative.

Aplikuesit duhet të jetë persona me përvojë profesionale mbi 1 vite në të pakten njëren nga fushat e lartë përmendura.

Afati për aplikim është nga data 23.09.2022 deri më datën 30.09.2022

Ju lutem dërgoni brenda kësaj periudhe të aplikimit CV-në tuaj në posten elektornike pajtim.balaj@rks-gov.net

Për më shumë informata mund të kontaktoni në emailin e njëjtë.

Podujevë
23.09.2022

Drejtör
Pajtim Balaj